

Ndryshime në Disability Support Pension (DSP) për klientët të cilëve u është dhënë pagesa mbas 10 Majit 2005

Changes to Disability Support Pension (DSP) for Customers granted payment after 10 May 2005 — Albanian

Nga 1 Korriku 2006 Qeveria Australiane do të bëjë disa ndryshime shumë të rëndësishme në sistemin e ndihmës sociale për t'i ndihmuar njerëzit të punësohen. Këto ndryshime përfshijnë inkurajimin dhe mbështetjen e personave në Disability Support Pension (DSP) (Pension për Mbështetje të të Paafhtëve), që kanë aftësi të punojnë, të gjejnë punë.

Si do të ndikohem unë nga ndryshimet?

Personat që kanë marrë DSP pas 10 Majit 2005 mund të rishikohen nën dritën e rregullave të reja. Për shumicën e njerëzve kjo do të ndodhë dy vjet pasi t'u jetë dhënë DSP.

Në se ju rivlerësoheni, ju mund të referoheni për një Job Capacity Assessment (Vlerësimi i Kapacitetit për të Punuar). Ky vlerësim i ri do të ndihmojë në identifikimin e shërbimeve që ju nevojiten për të kapërcyer ndonjë problem mjekësor ose problemet që ju ndalojnë të gjeni punë dhe ta mbani atë. Ajo do të sigurojë gjithashtu që aftësia juaj për punë të vlerësohet sa më shpejt.

Job Capacity Assessor (Vlerësuesi i Aftësisë për Punë) i juaj do të jetë në gjendje të organizojë shërbimet për t'ju ndihmuar të kapërceni pengesat për punë.

Ju nuk do të jeni më i ligjshëm për DSP në se jeni vlerësuar që:

- jeni në gjendje të punoni të paktën 15 orë në javë pa nevojë mbështetjeje, ose
- me ndihmë dhe trajnim, brenda dy viteve jeni në gjendje të punoni të paktën 15 orë në javë pa nevojë mbështetjeje.

Në se situata është e tillë, ju mund të transferoheni në një pagesë më të përshtatshme të ardhurash. Në përgjithësi kjo do të jetë Newstart Allowance (Pagesa për Personat që Kërkojnë Punë).

Në shumicën e rasteve ju do ta mbani Pensioner Concession Card (Kartën e Konçesionit të Pensionistëve) dhe do të merrni akoma Pharmaceutical Allowance (Pagesë për Ilaçet) dhe Telephone Allowance (Pagesë për Telefonat).

A do të ndikohen nga ndryshimet njerëzit që janë të verbër përgjithmonë?

Jo. Nuk ka ndryshime në rregulloren e ligjshmërisë për DSP për njerëzit që janë të verbër përgjithmonë.

Çfarë shërbimesh do të ketë si ndihmë për mua?

Do të ketë më shumë shërbime punësimi të vlefshme për t'ju ndihmuar të gjeni një punë që ju jeni në gjendje ta bëni. Ata do t'ju sigurojnë:

- ndihmë të specializuar për njerëzit e paafhtë
- shërbime riaftësimi
- mbështetje të vazhdueshme në se është e nevojshme

Ju jeni të ligjshëm për këto shërbime edhe në se nuk ju kërkohet të shikoni për punë. Job Capacity Assessor i juaj do t'ju ndihmojë për të identifikuar shërbimin e punësimit të përshtatshëm për ju.

Çfarë ndihme tjetër do të ketë?

Në se jeni punë, ju ose punëdhënësi mund të keni të drejtë për të gjitha ose disa prej të mëposhtëmeve:

- Mobility Allowance (Pagesë për t'ju Ndihmuar me Transportin). Kjo siguron ndihmë financiare për njerëzit me paaftësi që kërkojnë të gjejnë punë për 15 orë në javë ose më shumë, që janë duke punuar me pagesë, që bëjnë trajnim zanati-ose ndonjë kombinim të tyre-që nuk janë në gjendje të përdorin transportin publik. Në se bëni pjesë në ndonjërin prej këtyre kategorive, nga 1 Korriku 2006 ju mund të keni të drejtë të merrni këtë pagesë prej \$100 në dy javë.
- Employment Entry Payment (Pagesa për Hyrje në Punë). Kjo është një pagesë që jepet vetëm një herë rreth \$300 për të ndihmuar njerëzit me paaftësi kur fillojnë një punë të re.

- Financimin nën Workplace Modifications Scheme (Skemën e Modifikimeve të Vendit të Punës). Kjo mund të ripaguajë punëdhënësin tuaj deri në \$10,000 kundrejt kostos së përshtatjes së vendit të punës për paaftësinë tuaj.

Çfarë do të ndodhë nëse puna nuk më përshtatet?

Nëse gjeni një punë dhe ju ndërprehet DSP, dhe pastaj e humbni ose largoheni nga ajo punë brenda dy viteve, DSP i juaj do t'ju kthehet. Mos harroni, nëse keni arsye që nuk mund të qëndroni të punësuar, ju do të keni mundësi të ktheheni në DSP në çfarëdo kohe brenda dy viteve.

Nëse ju ndërpritet DSP për arsye se gjeni punë, ju mund të mbani Pensioner Concession Card tuajën edhe për një vit.

A do të kem ndonjë detyrim gjatë kohës që jam në DSP?

Jo. Nuk do t'ju kërkohet të shikoni për punë ose të ndërmerrni aktivitete të tjera të lidhura me punësimin gjatë kohës që jeni në DSP.

Po pastaj?

Nuk keni nevojë të bëni asgjë tani. Në rishikimin tjetër pas 1 Korrikut 2006, që për shumicën e njerëzve do të ndodhë dy vjet pasi t'ju jepet DSP, Centrelink mund të vlerësojë të drejtën tuaj nën rregullat e reja dhe do të diskutojë se si ndikojnë këto ndryshime tek ju. Por nëse ju dëshironi të kërkoni për punë më përpara, nuk keni nevojë të prisni deri atëherë. Kontaktoni Centrelink për t'ju vënë ju në kontakt me shërbimin dhe ndihmën e duhur.

Për më shumë informacion në Shqip, telefononi **13 1202*** ose vizitoni adresën tonë të internetit **www.centrelink.gov.au**

* Thirrjet me numrat që fillojnë me "13" nga një shërbim standard telefonik mund të bëhen prej kudo në Australi për jo më shumë se kostoja e një thirrje lokale (çmimi për thirrje mund të ndryshojë në varësi kompanisë së telefonit që ju siguron shërbimin telefonik). Thirrjet me numrat "1800" janë falas. Çmimet për thirrjet nga telefonat publikë dhe celularët mund të jenë më të larta.